



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:083328

Datë: 22.10.2024

Numri i dokumentit: 06335498

KPPP.nr. 482/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përbarimore të kreditorit Komiteti Olimpik i Kosovës, me numër të regjistrimit 51105524 dhe seli në Prishtinë, rr. “Agim Ramadani”, nr. 253, Kati 3, kundër debitorit Olive Medical Group, me numër unik identifikues 810028705 dhe seli në Prishtinë, lagjia Kalabria, rr. “Fadil Hoxha”, kati 2, objekti EXDC-4, duke vepruar sipas prapësimit të debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 167/24, i lejuar me datë 28.02.2024, nga Përbaruesi Privat Isa Gacaferi, me seli në Lipjan, jashtë seancës, me datë 22.10.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Olive Medical Group, me numër unik identifikues 810028705, ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 167/24, i lejuar me datë 28.02.2024, nga Përbaruesi Privat Isa Gacaferi.
- II. Urdhri Përbarimor P.nr. 167/24, i lejuar me datë 28.02.2024, nga Përbaruesi Privat Isa Gacaferi, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komiteti Olimpik i Kosovës, mbi bazën e dokumentit të besueshëm, Faturës 2022/054 e datës 31.10.2022 dhe Faturës 2023/043 e datës 22.12.2023 ka lejuar Urdhrin Përbarimor P.nr. 167/24, të datës 28.02.2024, me të cilin është urdhëruar debitori Olive Medical Group që kreditorit t’ia paguaj shumën prej EUR 50,000.00, me kamatë vonesë 8% vjetore, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, me arsyetimin se faturat në bazë të cilit mbështetet propozimi për përmbarim nuk kanë tipare të përmbarueshmërisë, ngase debitori është në pritje të një marrëveshje të re me kreditorin duke iu referuar nenit 116 Klauzula Rebus Sic Stantibus të LMD, për arsye se gjendja financiare, të hyrat dhe profiti i debitorit ka ndryshuar në tërësi në dëm të kompanisë duke e bërë kështu të pamundur financiarisht përmbushjen e detyrimeve ndaj kreditorit. Ka shtuar se për shkak të rrethanave të ndryshuara dhe gjendjes financiare duket qartë se kontrata me kreditorin nuk i përgjigjet më asaj gjendje e cila është pritur nga debitori. Me tej, ka theksuar se me qëllim të ndryshimit të marrëveshjes mes palëve, me kreditorin kanë mbajtur takime të ndryshme dhe i kanë ofruar propozim për ndërprerjen e bashkëpunimit aktual dhe mundësisë së ndryshimit të raportit aktual me një formë të re të bashkëpunimit ashtu që një pjesë e detyrimit të përmbushet me para, ndërsa pjesa tjetër e detyrimit të përmbushet përmes ofrimit të shërbimeve mjekësore dhe laboratorike. Në fund, ka shtuar se me datë 21.12.2023 kreditori ka dërguar e-mail zyrtar debitorit me të cilin i ka propozuar që borxhi i vitit 2022 në vlerë prej EUR 25.000, të paguhet në shumë prej EUR 10.000, gjatë muajit dhjetor të vitit 2023, ndërsa pjesa tjetër e mbetur të përmbushet deri më 1 qershor 2024, sipas planit të pagesave, mirëpo që përkundër këtij propozimi të ofruar nga ana e kreditorit, i njëjti prapëseprapë ka proceduar tutje me lëshimin e dy faturave. Prandaj, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj, ashtu që urdhri përmbarimor të anulohet.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se e kundërshton prapësimin e debitorit duke shtuar se debitori nuk iu është përgjigjur thirrjeve apo e-mailave të kreditorit më parë. Ndërsa, ka shtuar se pretendimi se palët janë pajtuar për ndryshimin e lartësisë së borxhit janë të pabazuara pasi që kjo ka qenë vetëm negociim mes palëve po nuk është arritur asnjë marrëveshje për përmbushje. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit në përgjigje në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton

faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Gjykata vlerëson se përmbartuesi privat ka lejuar urdhrin përmbartimor mbi bazën e dokumentit të besueshëm, përkatësisht faturave nr. 2022/054 dhe nr. 2023/043, fatura këto të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar shërbimet të cilat kreditori i ka ofruar për llogari të debitorit, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbartimor, i plotësojnë kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njetat i janë bashkëngjitur propozimit për përmbartim në origjinale.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit për gjendjen financiare të rënduar dhe ndryshim të rrethanave në kuptim të nenit 116 të LMD-së, mirëpo gjeti se të njetat janë pretendime të natyrës materiale të cilat nuk mund të jenë objekt trajtimi në këtë procedurë, ngase procedura përmbartimore i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal në bazë të cilit gjykata nuk ka tagër të lëshohet në vlerësimin e rrethanave të tjera, përjashtimisht vlerësimin të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbartimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21 dhe 29 të LPP-së. Megjithatë, gjykata rikujton se vendosja në këtë çështje përmbartimore nuk e paragjykon të drejtën e palës debitore që, lidhur me pretendimet e tilla, të inicioj proces të rregullt civil pranë gjykatës kompetente.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera të debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo gjeti se të njetat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrin përmbartimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 482/24, datë 22.10.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.